

[leter me koke e perkthyesit]

Noteri Publik ne Antelias

Me Halim AOUAD

Tel: 04/404336

Cel: 03/404336

Akt dhurimi kuotash



Sot, me date 14.06.2007, ne pranine time, Noterit Publik ne Antelias, i nenshkuari Pierre Semaan, deklaroi: "Une, i nenshkuari Pierre Semaan jam ortak zoterues i 40% te kapitalit te shoqerise Iceberg Publicity Sh.p.k., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e cila eshte krijuar sipas ligjit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 22489, date 22.12.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ekuivalent me 40 (dyzete) vota ne kete shoqeri.

Meqenese:

Znj. Rafaela Rica zoteron pjesen tjeter te kapitalit te shoqerise prej 60%, i barabarte me 60 vota,

Une nuk banoj me ne Republiken e Shqiperise duke filluar nga viti 2006, pasi aktualisht banoj ne Liban,

Une nuk e kam te mundur te ushtroj detyrat dhe keshtu te perfitoj te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i 40% te kapitalit te shoqerise se siperpemundur,

Une nuk deshiroj t'ia transferoj keto kuota nje personi te trete jashte shoqerise

Me vullnetin tim te lire dhe te parevokueshem bie dakort si vijon:

1. I transferoj, nepermjet dhurimit, kuotat dhe te drejtat lidhur me to qe une zoteroj ne shoqerine Iceberg Publicity Sh.p.k., ortakut tjeter te kesaj shoqerie Rafaela Rica, duke i kaluar asaj te gjitha te drejtat, te drejten e dividetit lidhur me keto kuota si edhe detyrimet lidhur me to, perfshire borxhet, shumat e detyrueshme per t'u paguar kundrejt bankave ose ndonje

personi tjetër si tregtar, agjent etj., pasi une e kam vene ne dijeni ortaken Rafaela Rica mbi te gjitha detyrimet dhe barret ne fjale dhe ajo ka pranuar gjendjen e tyre, te drejtat dhe detyrimet lidhur me to.

2. Kuotat e mia ia dhuroj ortakes Rafaela Rica me vleren e tyre nominale siç parashikohet ne aktet themeluese te shoqerise Iceberg Publicity Sh.p.k.; keto kuota dhe te drejtat e votes lidhur me to jane te lira nga çdo pretendim i paleve te treta dhe Znj. Rafaela Rica do te gezoje duke filluar nga data e ketij akti te gjitha te drejtat dhe detyrimet lidhur me keto kuota me pranimin nga ana e saj te ketij dhurimi, duke perfshire, por pa u kufizuar vetem ne, te drejten e votes, te drejten e dividendit, te drejten e mbulimit te humbjeve etj.
3. Ortakja Rafaela Rica nepermjet deklarates se saj me ka njoftuar mbi pranimin e dhurimit dhe merr persiper te kryeje te gjitha formalitetet e nevojshme lidhur me dhurimin e ketyre kuotave ne favor te saj, ne menyre qe ky dhurim te kete efekte ligjore dhe te permbushe detyrimet e kerkuara nga ligji dhe aktet themeluese te shoqerise lidhur me kalimin e pronesise se ketyre kuotave ne emer te saj duke kryer shenimin e nevojshem ne Regjistrin Tregtar ne Tirane.
4. Shpenzimet dhe tarifat qe rezultojne nga kjo kontrate i ngarkohen Znj. Rafaela Rica se bashku me taksat dhe tatimet e zbatueshme ne kete rast.

Pierre SEMAAN
[nenshkrimi]

Nr. 5633/2007

Vertetuar nga ana ime autentitciteti i nenshkrimimit te **Z. Pierre Jamil Semaan**, me kombesi libaneze, lindur ne Monrovia me 1963, me nr. regjistri ne gjendjen civile 59 Sakiet El Misk, sipas kartes se identitetit me fotografi, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili nenshkroi perpara meje dhe une, **Halim AOUAD**, i diplomuar ne drejtesi, Noter Publik ne Antelias, pasi ia lexova kete akt dhe mora pelqimin e tij, e regjistroj kete sot dite e Enjte, me date 14 Qershor 2007.

Noteri Public ne Antelias
Halim AOUAD
[nenshkrimi dhe vula]

[vula dhe nenshkrimi i perkthyesit]

Nr. 5658/2007

Pare nga une, Z. H. AOUAD, noter ne Antelias, per te vertetuar nenshkrimin dhe vulen e vene me siper nga Znj. Schoucair, perkthyes e autorizuar, ne perkthimin qe une e vertetoj se eshte besnik dhe i vertete me tekstin origjinal te ruajtur se bashku me perkthimin ne arkivat e Noterise.

Bere ne Antelias

15 qershor 2007

REPUBLIKA LIBANEZE
Ministria e Puneve te Jashtme
Seksioni i legalizimeve
Nr. 101/65/2
Pare per legazim
Nenshkrimi i Z. H. AOUAD
Pa asnje pergjegjesi per
permbajtjen e dokumentit
16 qershor 2007
Z. Youssef Kreidi
Firma, vula

REPUBLIKA LIBANEZE
Ministria e Puneve te Jashtme
Seksioni i legalizimeve
Nr. 101/66/2
Pare per legazim
Nenshkrimi i Z. H. AOUAD
Pa asnje pergjegjesi per
permbajtjen e dokumentit
16 qershor 2007
Z. Youssef Kreidi
Firma, vula